



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. 3810/prot
2

2318 /2024

PROJEKT-VENDIM - Nr. 8

Për

“Miratimin e taksës në infrastrukturë për ndërtimet për objektin : “Rikonstrukcion i skemës të furnizimit me ujë për fshatin Podgorie”

Në mbështetje të ligjit Ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 1 dhe neni 54, gërma f, neni 64, gërma c, i ndryshuar, Ligji nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, Neni 11/1 “Punime të cilat kërkohen të pajisen me leje ndërtimi infrastrukturë”, pika 1, Ligji nr.9632, datë 21.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27 “Taksa e ndimimit në infrastrukturë”, pika 3, gërma b, Vendimi i Këshillit të Bashkisë Maliq nr.136, datë 26.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Maliq, penalitetet për shkeliet apo kundravajtjet Administrative për vitin 2024”, Pakdeta fiskale, kapituulli A, pika 4, “Lojet e ndërtimeve dhe investimeve”, paragrafi 3;

Propozoj :

1. Të miratojë taksën e ndikimit në infrastrukturë për projektin me objekt: ***“Rikonstrukcion i skemës të furnizimit me ujë për fshatin Podgorie”***.
2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë do të jetë në masën 0.1%.
3. Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit do të bëjë përlllogaritjen e vlerës së taksës së ndimimit në infrastrukturë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bazuar në llogaritjen do të bwjw faturën për arkëtimin për pagesë dhe Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore do të bëjë arketimin e detyrimit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Korçë.

KRYETAR I BASHKISË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. 3910/2 prot

23 / 8 / 2024

RELACION

Për

“Miratimin e taksës në infrastrukturë për ndërtimet për objektin : “Rikonstruksion i skemës të furnizimit me ujë për fshatin Podgorie”

Në mbështetje të ligjit Ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 1 dhe neni 54, gërma f, neni 64, gërma c, i ndryshuar, Ligji nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, Neni 11/1 “Punime të cilat kërkohen të pajisen me leje ndërtimi infrastrukturë”, pika 1, Ligji nr.9632, datë 21.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27 “Taksa e ndimimit në infrastrukturë”, pika 3, gërma b, Vendimi i Këshillit të Bashkisë Maliq nr.136, datë 26.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Maliq, penalitetet për shkelje, apo kundravajtjet Administrative për vitin 2024”, Paketa fiskale, kapitulli A, pika 4, “Lojet e ndërtimeve dhe investimeve”, paragrafi 3, nga ana e Bashkisë Maliq është kërkuar nga ana e Ajjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimi implementimi i projektit për furnizimin me ujë të fshatit Podgorie.

Duke qënë se ky investim është në interes së komunitetit dhe për miratimin e lejës së ndërtimit kërkohet pagesa e taksës në infrastrukturë, kërkohet të miratohet taksa e ndikimit në infrastrukturë për projektin me objekt: ***“Rikonstruksion i skemës të furnizimit me ujë për fshatin Podgorie”***.

Për këtë objekt bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, Neni 11/1 “Punime të cilat kërkohen të pajisen me leje ndërtimi infrastrukturë”, pika 1, taksa e ndikimit në infrastrukturë të jetë në masën 0.1%.

Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit do të bëjë përlogaritjen e vlerës së taksës së ndimimit në infrastrukturë, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit bazuar në llogaritjen do të bëjë faturën për arkëtimin për pagesë dhe Drejtorja e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore do të bëjë arkëtimin e detyrimit.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtorja e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore dhe Drejtorja e Financës dhe Buxhetit.

